

Udhëzime për Autorët

I. Kriteret për publikim

II. Llojet e artikujve

- A. Kërkim Shkencor Origjinal
- B. Raportim Shpërthimi Epidemik
- C. Njoftime për Politikën Shëndetësore
- D. Lajmërimet për Lexuesit

III. Formati i raportimit

IV. Dorëzimi, Pranimi dhe Afatet Kohore të Publikimit

V. Informacione Kontakti

I. Kriteret për publikim

A. **Përshtatshmëria.** Buletini i ISHP-së publikon të dhëna dhe informacione me interes për profesionistët e shëndetit publik, kërkuesit shkencorë, profesionistët e kujdesit shëndetësor, stafin pedagogjik, studentët, dhe median. Raportet kryesisht bazohen në disiplinën e epidemiologjisë dhe shëndetit publik. Rekomandimet e dhëna duhet të jenë brenda fushës së interesit të ISHP-së.

B. **Origjinaliteti.** Raportet duhet të përmbajnë vetëm të dhëna të pa botuara më parë.

C. **Cilësia.** Analizat e paraqitura në raporte duhet të bazohen në metodat shkencore të pranuar gjerësisht dhe duhet të përfshijnë të dhëna të mjaftueshme për të hulumtimin e përshtatshëm të problemit të shëndetit publik në fjalë.

D. **Periudha kohore.** Raportet duhet të përmbajnë të dhëna më të fundit të gjeneruara nga studimet, sistemet e survejancës ose studime të natyrave të tjera. Raportet lidhur me hetime në vijim e sipër ose që kanë përfunduar pak kohë më parë kanë prioritetin më të lartë për botim.

II. Llojet e artikujve

Në Buletinin e ISHP-së botohen këto lloje artikujsh: A) Kërkim Shkencor Origjinal, B) Raportim Shpërthimi Epidemik, C) Shënime për Politikën Shëndetësore, dhe D) Lajmërimet për Lexuesit.

A. **Kërkim Shkencor Origjinal.** Këtu përfshihen raporte të studimeve apo hetimeve epidemiologjike të përfunduara të cilat i japin përgjigje pyetjeve të ndryshme me interes për shëndetin publik. Në mënyrë ideale, përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve duhet të orientojnë praktiken e ardhshme të shëndetit publik. Kërkimet Shkencore Origjinale duhet të kenë më pak se 2000-2500 fjalë dhe të përfshijnë jo më shumë se 10 referenca si dhe të kenë maksimumi 4-5 tabela/figura. Artikujt që tejkalojnë këto limite mund të konsiderohen për publikim vetëm nëse, sipas opinionit të Redaktorit të Buletinit, ky përjashtim është i justifikueshëm.

Udhëzim: Këta artikuj duhet të jenë të thjeshtë sepse ata, idealisht, duhet thjeshtë të përmbledhin analizën dhe rekomandimet lidhur me çështjen e interesit dhe jo të sqarojnë çdo detaj apo shifër në raport. Në funksion të thjeshtësisë është vendosur dhe rregulli i 10 referencave ose më pak. Një mënyrë e mirë për të kontrolluar nëse artikulli është i thjeshtë është të provoni nëse, me një apo dy fjali, t'i tregoni lexuesit mesatar se për çfarë bën fjalë ky raport dhe çfarë duhet bërë më tej lidhur me problemin në fjalë.

1. **Abstrakti.** Abstrakti nuk duhet të përmbajë më shumë se 150 fjalë. Abstrakti duhet të jetë i pastrukturuara (pa rubrika) dhe të paraqesë një përmbledhje sintetike të materialit të plotë të paraqitur në raport duke adresuar këto pika: kush, çfarë, kur, ku, pse dhe si?

2. **Hyrje.** Hyrja e një Artikulli Shkencor Original duhet të përshkruajë se cili është problemi i interesit dhe përse ky problem është i rëndësishëm të hetohet dhe të publikohet. Gjithashtu, ky seksioni duhet të jetë i tillë që të jetë i kuptueshëm për çdo profesionist të shëndetit publik pa njohuri specifike për tëmen që trajtohet.

3. **Materiali dhe metodat.** Në 1-2 paragrafë duhet të ofrohet përshkrimi i metodave të përdorura për analizat përkatëse. Detajet në këtë paragraf mund të përfshijnë burimin e të dhënave, mënyrën e mbledhjes së tyre, përkufizimin e rastit ose kriteret e përfshirjes së subjekteve në studim, periudhën e studimit, llojet e kampioneve të marra dhe testet e realizuara (dmth, serologjike, kultura apo toksikologjike) si dhe metodat statistikore të përdorura. Nëse bëhet fjalë për të dhëna nga studime apo sisteme survejance, atëherë duhet të raportohet dhe niveli i përgjigjes.

4. **Rezultatet.** Në këtë seksion duhet të paraqiten në mënyrë të përmbledhur rezultatet kryesore të analizës së të dhënave. Për shembull mund të përfshihen elemente përshkrues (dmth, koha, vendi, personi) dhe të dhëna epidemiologjike, trendet kohore dhe nivelet e sëmundjes, trajtimi/et dhe rezultatet. Raportimi i rasteve apo seria e rasteve duhet të përfshijë të dhëna lidhur me ekspozimin, shenjat dhe simptomat, diagnozën fillestare, gjetjet laboratorike dhe radiologjike, trajtimin, dekursin klinik, dhe rezultatet e trajtimit. Në përgjithësi, të dhënat që përshkruhen këtu duhet të reflektohen dhe në tabelat apo figurat përkatëse.

5. **Masat e ndërmarra.** Kur është e përshtatshme, duhet të formulohen një ose dy fjali ku të përshkruhen masat e kontrollit të ndërmarra në këtë rast.

6. **Përfundime.** Në këtë seksion duhet të përmbledhen konkluzionet e raportit bazuar në interpretimin e rezultateve si dhe të përcillem mesazhet (rekomandimet) për shëndetin publik në terma të parandalimit dhe kontrollit. Nëse është e mundur, rezultatet aktuale duhet të vendosen në kontekstin e studimeve të mëparshme lokale apo ndërkombëtare si dhe të sillen shembuj të ndërhyrjeve të suksesshme të shëndetit publik. Rekomandimet duhet të jenë të mbështetura vetëm në analizat e raportit aktual.

7. **Referencat.** Nuk duhet të jenë më shumë se 10. * Për shumbuj referencash shih më poshtë).

8. **Kutia përmbledhëse.** Në 1-2 fjali për secilën, autorët duhet t'i përgjigjen këtyre pyetjeve: Cfarë dihet aktualisht për çështjen në fjalë? Cfarë të rejtash sjell ky raport? dhe Cilët janë implikimet për shëndetin publik? Për shkak se këto përgjigje përmbajnë mesazhet kyce të shëndetit publik si the justifikimin për publikimin, autorët duhet që idealisht ta skicojnë kutinë përmbledhëse përpara shkrimit të raportit.

* Referencat duhet t'i përshtaten stilit Harvard (Autori, viti) në tekst.

-Një autor. Për shembull (Burazeri 2013).

- Dy ose më shumë autore të cituar në të njëjtën pikë në tekst: (Autori 1 viti; Autori 2 viti). Për shembull (Hansen 2005; Larson 2004). Autorët duhet të renditen sipas rendit alfabetik.

- Tre ose më shumë autorë: Kur citohet burime nga tre ose më shumë autorë, citoni emrin e tyre sipas radhës. Për shembull (Malkovich, Hinger & Green 2005).

Artikuj në Revista Shkencore:

- Jennings, P 1997, 'The performance and competitive advantage of small firms: a management perspective', International Small Business Journal, vol. 15, no. 2, pp. 63-75. (Citimi në tekst: (Jennings 1997)).

- Conley, TG & Galeson, DW 1998, 'Nativity and wealth in mid-nineteenth century cities', *Journal of Economic History*, vol. 58, no. 2, pp. 468-493. (Citimi nw tekst: (Conley & Galeson 1998)).
- Liveris, A 2011, 'Ethics as a strategy', *Leadership Excellence*, vol. 28, no. 2, pp.17-18. Available from: ProQuest. [23 June 2011]. (Citimi nw tekst: (Liveris 2011))
- Bustamante, C 2014, 'Libraries welcome writers in residence', *Library Journal*. Available from: <<http://lj.libraryjournal.com/2014/09/industry-news/libraries-welcome-writers-in-residence/>>. [29 September 2014]. (Citimi nw tekst: "Over a dozen writers applied before the August 31 deadline" (Bustamante 2014, 'Public library of Cincinnati', para. 4).)
- Segon, M & Booth, C 2011, 'Bribery: what do Australian managers know and what do they do?', *Journal of Business Systems, Governance and Ethics*, vol. 6, no. 3, pp. 15-29. Available from: <http://www.jbsge.vu.edu.au/issues/vol06no3/Segon_&_Booth.pdf>. [20 October 2014]. (Citimi nw tekst: (Segon & Booth 2011)).

Citime nga Interneti/Website:

- Improve indigenous housing now, government told, 2007. Available from: <<http://www.architecture.com.au/i-cms?page=10220>>. [8 February 2009]. (Citimi nw tekst: (Improve indigenous housing 2007)).
- Jones, MD n.d., Commentary on indigenous housing initiatives. Available from: <<http://www.architecture.com.au>>. [6 June 2009]. (Citimi nw tekst: (Jones n.d.)).
- Resources 2006) Department of Industry, Tourism and Resources 2006, Being prepared for an influenza pandemic: a kit for small businesses, Government of Australia. Available from: <<http://www.innovation.gov.au>>. [28 February 2009]. (Citimi nw tekst: (Department of Industry, Tourism and Resources 2006)).

Citime nga Librat:

- Holt, DH 1997, *Management principles and practices*, Prentice-Hall, Sydney. (Citimi nw tekst: (Holt 1997)).
- McCarthy, EJ, William, DP & Pascale, GQ 1997, *Basic marketing*, Irwin, Sydney. (Citimi nw tekst: (McCarthy, William & Pascale 1997)).
- Bond, WR, Smith, JT, Brown, KL & George, M 1996, *Management of small firms*, McGraw-Hill, Sydney. (Citimi nw tekst: (Bond et al. 1996)).

B. Raportim Shpërthimi Epidemik. Këto duhet të ndjekin në përgjithësi formatin e Artikujve Shkencorë Origjinalë, me disa elementë specifike lidhur me raportimin e shpërthimit.

Udhëzim: Me sa të jetë e mundur, një Raport Shërthimi Epidemik duhet të formulohet në mënyrë kronologjike; pra duhet të tregojë një histori të caktuar në vijimësi.

1. **Abstrakti.** Në përgjithësi, paragraphi Hyrje duhet të fillojë me 1-3 fjali ku të përshkruhet ekzistenca e një shpërthimi epidemik apo problemi të shëndetit publik. Gjithashtu, zakonisht ky paragraph duhet të përmbajë: 1) një përshkrim të faktit që u krye një hetim epidemiologjik, periudhën e këtij hetimi dhe nga kush u krye ai; 2) gjetjet më interesante apo më të rëndësishme; 3) veprimet e ndërmarra për kontrollin e shpërthimit; dhe, 4) implikimet për shëndetin publik dhe veprimet që duhet të ndërmerren në përgjigje të hetimit epidemiologjik.

2. **Hyrje.** Në 1-2 paragrafë duhet të ofrohet përshkrimi i shpërthimit epidemik, vendin, kohës dhe personave të prekur.

3. **Hetimi dhe rezultatet.**

a. Së pari, paraqisni hetimin fillestar dhe gjetje e tij. Ketu mund të përfshihen: 1) përshkrimi i vendit dhe mënyrës sesi shpërthimi në fjalë

erdhi në vëmendjen e autoriteteve të shëndetit publik; 2) përshkrimi klinik i rastit apo rasteve; 3) rezultatet fillestare të testeve të kryera; 4) hipotezat dhe rezultatet.

b. Më pas, përmbliidhni të gjithë hetimin epidemiologjik, duke përfshirë: përkufizimin e rastit, aktivitetet për gjetjen/zbulimin e rasteve, metodat e hetimit, dhe rezultatet. Rastet duhet të numërohen dhe përshkruhen sipas karakteristikave klinike, trajtimit dhe rezultateve, si dhe sipas kohës, vendit dhe personit.

c. Më pas, paraqisni metodat dhe rezultatet e cdo studimi epidemiologjike analitik.

d. Në fund, paraqisni rezultatet e cdo testimi mikrobiologjik, toksikologjik apo të natyrave të tjera, të pasuar nga rezultatet e testimit të kampioneve mjedisore.

4. **Përgjigja e shëndetit publik.** Kur është e përshtatshme, bëni një përshkrim të shkurtër ku të përmbliidhni cdo ndërhyrje të shëndetit publik të ndërmarrë si dhe rezultatet e këtyre ndërhyrjeve.

5. **Referencat.** Shih Kërkim Shkencor Original.

6. **Kutia përmbledhëse.** Shih Kërkim Shkencor Original.

C. Njoftime për Politikat Shëndetësore. Njoftimet për Politikat Shëndetësore synojnë bërjen publike të politikave apo rekomandimeve zyrtare (të ISHP-së, për shembull). Maksimumi i fjalëve për këtë lloj raporti është 1400 fjalë. Lejohen deri në 3 tabela/figura ose kuti me mesazhe. Njoftimet për Politikat Shëndetësore nuk duhet të përmbajnë seksion Diskutimi, si dhe nuk është e nevojshme të përmbajnë kutinë përmbledhëse. Njoftimet për Politikat Shëndetësore mund të variojnë në mënyrë të konsiderueshme. Një guidë jepet në vijim.

1. **Abstrakti.** Abstrakti duhet të mos ketë më shumë se 150-200 fjalë. Ai mund të përmbajë disa ose të gjithë prej këtyre elementëve: një fjali hyrëse që e orienton lexuesin për çështjen në fjalë, një përshkrim i shkurtër i problemit të shëndetit publik, një përshkrim i shkurtër i arsyeve për politikat shëndetësore ose rekomandimet, dhe 1-2 fjali ku të përshkruhen konkluzionet dhe implikimet për shëndetin publik të politikave të reja shëndetësore apo rekomandimeve.

2. **Sfondi.** Njoftimet për Politikat Shëndetësore duhet të përmbajnë një paragraf pas Abstraktit që përmbledh informacione të lidhura me politikën përkatëse dhe që mund të ndihmojë lexuesit të kuptojnë kontekstin dhe nevojën për politikat apo rekomandimet që propozohen.

3. **Metodat.** Këtu duhet të përshkruhen metodat e përdorura për formulimin e politikave ose rekomandimeve, duke përfshirë përgjigjet ndaj disa ose gjithë pyetjeve në vijim:

a. Kush ka qënë i përfshirë në prodhimin e udhëzimeve ose rekomandimeve, dhe në c'mënyrë ishte i/e përfshirë?

b. Cilat të dhëna bazë u morën në konsideratë?

c. Cila ishte arsyeja kryesore për marrjen në konsideratë të të dhënave bazë? U përjashtua ndonjë e dhënë në këtë kontekst dhe, nëse po, pse?

4. **Arsyeja kryesore dhe të dhënat.** Njoftimet për Politikat Shëndetësore duhet të përmbajnë një rishikim të saktë të arsyeve për politikat ose rekomandimet dhe evidencave shkencore për formulimin e tyre. Ky seksion duhet të përfshijë shpjegime se në c'mënyrë politikat apo rekomandimet kontribuojnë më tej ose ndryshojnë nga politikat dhe rekomandimet e përdorura deri tani.

5. **Paraqitja e politikave apo rekomandimeve.** Politikat apo rekomandimet duhet të shprehin qartë se kur hyjnë në fuqi dhe cilët persona prek dhe në çfarë rrethanash.

6. **Komente.** Këtu duhet të përshkruhet impakti i pritshëm i politikave ose rekomandimeve të reja dhe planet për vlerësimin e këtyre politikave dhe rekomandimeve.

7. **Referencat.** Shih Kërkim Shkencor Original

C. **Lajmërime për lexuesit.** Lajmërime për lexuesit përmbajnë lajmërimë për evente të ardhme të lidhura me shëndetin publik, kurse trajnimi, konferenca dhe publikime me interes për lexuesit e Buletinit. Lajmërimet zakonisht duhet të kufizohen në jo më shumë se 250 dhe do të redaktohet nga stafi editorial nëse kjo është e nevojshme.

III. Formati i raportimit

A. **Teksti.** Materialet duhet të dorëzohen në variantin Ëord.

B. **Referencat.** Referencat duhet të jenë sipas stilit Harvard.

C. **Tabelat dhe Figurat.** Tabelat duhet të krijohen në Ëord ose Excel. Figurat duhet të krijohen në Excel dhe të dërgohen në këtë variant në mënyrë që të kenë mundëis të editohen nga stafi editorial i Buletinit.

IV. Dorëzimi, Pranimi dhe Afatet Kohore të Publikimit

A. Materialet duhet të dorëzohen me email, në adresën: ervintoci@yahoo.com.

B. Brenda 2 javësh autorët do të marrin informacion nëse materiali i tyre do të pranohet ose jo në Buletin.

V. Informacione Kontakti

A. **Adresa postare:** Buletini i ISHP-së, Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë.